

Hapet thirrja për aplikime për bursa për stafin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin Perëndimor të Timisoarës në Rumani, për semestrin e dytë të vitit akademik 2020-2021

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin Perëndimor të Timisoarës në Rumani për semestrin e dytë të vitit akademik 2020-2021.

<https://www.uvt.ro/ro/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit me kohë të plotë për trajnim;

Kohëzgjatja e bursave:

- 5 + 2 ditë;

Fushat e studimit:

Për më shumë informacion për mobilitetet e stafit klikoni në adresën:

<https://ri.uvt.ro/erasmus-incoming-mobilitati-de-predare-si-formare-2/?lang=en>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin me kohë të plotë:

- CV;

- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës;
- Vërtetim punësimi në gjuhën shqipe;
- Vetëdeklarim nëse keni kryer më parë mobiltete në kuadër të programit Erasmus +, nëse po ku;
- Plani i mobilitetit për trajnim;

**Plani i mobilitetit është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen gjatë periudhës së mobilitetit.*

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për trajnim klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Training_outgoing-1.docx

Afati për aplikim: 8 Prill 2021

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!